



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2021:129691

Datë: 08.02.2023

Numri i dokumentit: 03954355

P..nr.01/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale në rivendosje, kundër të pandehurve I. H. nga fshati O. komuna e V. dhe A. H. nga fshati O. komuna e V. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.834/21 e datës 30.08.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 26.02.2022, në praninë e Prokurorit të shtetit Zef Prendrecaj, të pandehurve I. H. dhe A. H. si dhe mbrojtësit të të pandehurit të dytë av. Ruzhdi Maloku, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 08.02.2023 me datë 08.02.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.I PANDEHURI I PARË: I. H., nga i ati A., e ëma Sh. e vajzërisë B., i lindur më ..., në fshatin O. komuna e V., ku edhe tani jeton, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal ..., më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I PANDEHURI I DYTË: A. H., nga i ati A., e ëma Sh., e vajzërisë B., i lindur më ..., në fshatin O., komuna e V., ku edhe tani jeton, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal ..., më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës..

JANË FAJTORE

SEPSE: Me dt. 01.05.2021 rreth orës 18:20 minuta, në fshatin O., Komuna e V. të pandehurit I. H. dhe A. H. në bashkëkryerje dhe me dashje i kanë shkaktuar të dëmtuarit B. H. lëndime të lehta trupore, në atë mënyrë që i dëmtuari ka punuar si sigurim – roje në firmën “B. C.”, e cila ndërton rrugën në fshatin P. – O. dhe kur aty kanë kaluar dy të pandehurit, ata për shkak të mosmarrëveshjeve të më hershme familjare, të cilën e kanë pasur me të dëmtuarin, i pandehuri A. H. e ka sulmuar fizikisht dhe e ka goditur me një shkop druri – me dorëzën e fshesës, mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore të dëmtuarin, fillimisht e godet në kokë dhe më pas në pjesën e kofshës të djathtë, kurse i pandehuri I. H. me dashje me një mjet të

përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore- shkop druri e ka sulmuar dhe goditur të dëmtuarin në trup, më konkretisht në pjesën e pasme të kokës dhe në trup, ku me atë rast sipas ekspertizës mjeko-ligjore të dëmtuarit në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin,

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së”, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 47, 48,49, 69, 70 dhe neni 185 par.2 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe neni 365, 450 dhe 463 të KPPK-së, i

G J Y K O N

TË PANDEHURIT TË PARË: I. H. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë muaj (11), i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti,

TË PANDEHURIT TË DYTË: A. H. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë muaj (11), i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti,.

I dëmtuari B. H. udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore – juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shumën prej tridhjetë (30 €) euro.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej tridhjetë (30 €) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.834/21 e datës 30.08.2021, të cilën e ka plotësuar në seancën e shqyrtimit fillestar të datë 08.02.2023 sa i përket dispozitivit të aktakuzës kundër të pandehurve I. H. nga fshati O., komuna e V. dhe A. H. nga fshati O., komuna e V. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.02.2023, pasi që kjo çështje penale është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës përmes aktvendimit PA1.nr.969/22 të

datës 30.10.2022, në të cilën seancë i pandehuri i parë I. H. ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën e kryer, se është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërisë më, po ashtu edhe i pandehuri i dytë A. H. ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën e kryer, se është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsërisë më dhe njëherit i ka kërkuar falje palës së dëmtuar.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ta marrë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit të dytë A. H., av.Ruzhdi Maloku lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i mbrojturi i tij edhe pas konsultimeve të mëparshme dhe gjatë kësaj seance në mënyrë vullnetare dhe pa imponime e pranoi veprën penale të cilën e ka kryer dhe për këtë është penduar dhe i ka kërkuar falje edhe gjykatës edhe te dëmtuarit dhe ka premtuar se edhe në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin, andaj gjykatës i ka propozuar që me rastin e shqiptimit të dënimit ti merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe faktin se asnjëherë nuk ka qenë i gjykuar.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga të pandehurve, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga e pandehurit.

Provat e administruara dhe të vlerësuara

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-BD-341, i datës 01.05.2021, Raport nga Qendra emergjente e spitalit Sh. Z. për të dëmtuarin B.H., i datës 01.05.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarin I. H., i datës 01.05.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarin A. H. i datës 01.05.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje për viktimën B. H., i datës 04.05.2021, Procesverbal mbi marrjen në pyetje për dëshmitarin N. B. i datës 04.05.2021, Raporti Policor, i datës 01.05.2021, Raporti i policit, i datës 01.05.2021, foto – dokumentacioni në shtojcë prej dymbëdhjetë (12) fotografive si dhe të dhënat penale të të pandehurve.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Sa i përket të pandehurit të parë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht dëmin e shkaktuar të

dëmtuarit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do ta përsëris më këtë veprë penale si dhe faktin se është i pa gjykuar më parë. Sa i përket të pandehurit të dytë gjykata si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do ta përsëris më këtë veprë penale, i ka kërkuar falje të dëmtuarit si dhe faktin se më parë është i pa gjykuar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore - juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.01/23, datë: 08.02.2023

Numri i lëndës: 2021:129691
Datë: 08.02.2023
Numri i dokumentit: 03954355

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.